



## **AKTI I THEMELIMIT**

### **I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

#### **"FLORIDA FH" SHPK, ORTAKU I VETEM**

##### Neni 1

Une Ferat Hasaj, i datelindjes 1964, banues ne Vlore ne rrugen "Sadik Zotaj", pallati "Riviera", sot me date 22.04.2002 kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar "FLORIDA FH" sh.p.k. Ortaku i Vetem.

##### Neni 2

Selia e shoqerise do te jete ne Vlore, rruga "Sadik Zotaj", pallati "Riviera". Me vendim te Ortakut te shoqerise mund te hapen filiale, dege te shoqerise brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

##### Neni 3

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe pa afat dhe do te filloje nga momenti i rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar te Gjykates se Tiranës, me perjashtim te rasteve kur mbaron sipas parashikimeve ne ligj,ose kur vendos ortaku i shoqerise.

##### Neni 4

Shoqeria ka si objekt te veprimtarise te saj:

- *Veprimtari ne fushen e ndertimit dhe investimeve per ndertim.*
- *Punime dheu, sistemime, tarracime, ndertime civile, ekonomike, bujqesore, kulturore, sportive.*
- *Ndertime banesash, hotele, fshatra turistike,asfaltime, ndertim rruges, autostrada, tylene, ura, porte, aeroporte, vepra ujore, kanalizime, diga, vepra arti,impiante hidraulike, rregullime e sistemime te ndryshme,etj.*
- *Ndertim e shfrytezim te linjave inerte.*
- *Tregeti materialesh ndertimi, import-eksport.*
- *Transport mallrash e udhetaresh , brenda e jashte vendit .Hapje agjensi udhetaresh ; Hapje agjensi turistike , organizimi i turizmit brenda dhe jashte vendit ; Eksport- import artikuj te ndryshem industrial , lende drusore ; pajisje hidrosanitare, lende te pare per ndertim dhe per konstruksione metalike ; vegla pune ; impiante te ndryshme ; pajisje per ndricim ; pjese kembimi auto sherbim servis auto . Projektim e ndertim konstruksione metalike .*

##### Neni 5

Kapitali themelor i shoqerise eshte 100 000 leke i formuar ne mase te plote nga kontributi i ortakut te vetem te shoqerise .

Neni 6

Per nevojat e punes dhe te ushtrimit te aktivitetit te saj shoqeria mund te cele llogari ne cdo bank te njohur me ligj, qofte kjo private apo shteterore.

Neni 7

Per nevoja te punes kjo shoqeri mund te punesoje edhe punetore e specialiste te ndryshem me kontrate te rregullt pune sipas ligjeve ne fuqi.

Neni 8

Administrator i shoqerise eshte ortak i vetem Ferat Hasaj.

Neni 9


Dispozitat me te detajuara per shoqerine "FLORIDA FH" SH.P.K jane percaktuar ne Statutin e saj.

Neni 10

Akti i Themelimit formulohet ne kater kopje , nga te cilat , njera depozitohet ne zyren e noterise , njera ne Gjykatën e Rrethit Tirane , njera ne Zyren e Tatimeve dhe tjetra e katerta mbahet ne dokumentet e Shoqerise.

**ORTAKU I VETEM**

**FERAT HASAJ**



**STATUTI**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"FLORIDA FH" SH.P.K. ORTAKU I VETEM**

**FORMA, BAZA JURIDIKE , SELIA**

Neni 1

Une Ferat Hasaj, lindur me 18.02.1964 ne Fier e banues ne Vlore,  
Sot , me daten 22.04.2002, kam krijuar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar te emertuar  
"FLORIDA FH" shpk, Ortaku i Vetem.

Neni 2

Shoqeria eshte formuar sipas legjislacionit shqiptar dhe si person juridik fillon me  
regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane.

Neni 3

Shoqeria e ka seline ne Vlore, rruga "Sadik Zotaj", pallati "Riviera". Shoqeria  
mund te ndryshoje seline e saj me vendim te Ortakut te Vetem. Ajo mund te hapi dege ,  
filiale te saj ne gjithe teritorin e Shqiperise.

Neni 4

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me  
satutin e saj ne teritorin e Republikes se Shqiperise.

**FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKEVE**

Neni 5

Fusha e autoritetit te ortakut , perqindjet e fitimeve ose humbjet do te kete si  
kriter baze kapitalin e shoqerise si dhe kompetencat qe gezon ne marrjen e vendimeve te  
cdo karakteri te percaktuara ne kete statut.

**LIBRI I SHOQERISE**

Neni 6

Per te saktësuar veprimtarine e vet si dhe marrëdhëniet e punës , shoqëria do te ketë librin e vet i cili do te quhet libri i shoqërise.

## KONFIDENCIALITETI

### Neni 7

Ortaku i vetëm i shoqërise si dhe personat e tjerë te pranuar në shoqëri bien dakortë që te mos i ekspozojnë asnjë personi te jashtëm informacionet që disponon shoqëria , kontratat që do te lidhin si dhe planet ose qëllimet që ka për te ardhmen.

### Neni 8

Te gjitha aktet dhe dokumentat që nxirren nga shoqëria te destinuar per te tretet si letra , fatura , lajmerime dhe publikimet e ndryshme duhet te tregojnë dukshëm lexueshem emrin e shoqërise.

## OBJEKTI

### Neni 9

Shoqëria ka si objekt te veprimtarise se saj:

- *Veprimtari në fushën e ndërtimit dhe investimeve për ndërtim.*
- *Punime dheu, sisteme, terracime, ndërtime civile, ekonomike, bujqësore, kulturore, sportive.*
- *Ndërtime banesash, hotele, fshatra turistike, asfaltime, ndërtim rrugësh, autostrada, tynel, ura, porte, aeroporte, vepra ujore, kanalizime, diga, vepra arti, impiante hidraulike, rregullime e sisteme te ndryshme, etj.*
- *Ndërtim e shfrytëzim te linjave inerte.*
- *Tregëti materialeve ndërtimi, import-eksport.*
- *Transport mallrash e udhëtarësh , brenda e jashtë vendit .Hapje agjensi udhëtarësh ; Hapje agjensi turistike , organizimi i turizmit brenda dhe jashtë vendit ; Eksport- import artikuj te ndryshëm industrial , lende drusore ; pajisje hidrosanitare, lende te parë për ndërtim dhe për konstruksione metalike ; vegla pune ; impiante te ndryshme ; pajisje për ndricim ; pjese kembimi auto shërbim servis auto . Projektim e ndërtim konstruksione metalike .*

## KOHEZGJATJA E SHOQËRISE

### Neni 10

Shoqëria do te zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë pa afat , duke filluar nga data e regjistrimit te saj në regjistrin tregtar te gjykates se rrethit Tirane, me përjashtim te rastit te mbarimit te afatit sipas kushteve te parashikuara në ligj ose me vendim te ortakut te vetëm.

## KAPITALI THEMELTAR

### Neni 11

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 leke . Shoqeria mund te shtoje kapitalin e saj sipas vendimit te ortakut te vetem.

## KONTRIBUTET

### Neni 12

Kapitali themeltar i shoqerise "FLORIDA FH" shpk eshte i perbere nga kontributi ne para i derdhur teresisht nga Ortaku i Vetem, konkretisht

Ferat Hasaj 100 000 leke 100 % te kuotave te kaitalit themeltar.

## LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

### Neni 13

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferushme tek personat e trete ne qofte se vendos per kete asambleja e ortakeve . Gjithashtu ato jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.Sipas vendimit te asamblese se ortakeve ato mund te transferohen edhe jashte shtetit.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial.

## STRUKTURAT JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

### Neni 14

Shoqeria do ta konideroji qendren e vet si shoqeria nene e cila rast pas rasti do te hapet me ane dege , filiali ne te gjitha ato vende ku do ta shikoj interes ne permbushjen e qellimit te saj ne te gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise.

### Neni 15

Organet e shoqerise jane si me poshte :

- 1.asambleja e ortakeve.
- 2.Administratori.
- 3.Eventualisht eksperti kontabel.Detyrat e ekspertit ose eksperteve kontabel caktohen ne perputhje me ligjin per kontabilitetin.

## ADMINISTRATORI



#### Neni 16

Administrator i shoqerise eshte Ferat Hasaj, i cili jane pergjegjese ndaj te treteve per shkelje ligjore , per shkelje te statutit ose per gabime e faje te kryera gjate administrimit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

#### LIBRAT E SHOQERISE BILANCI , SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI

#### Neni 17

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje dokumentacion kontabel.Librin e shoqerise ne te cilin shenohen emri i plote i ortakeve , kapitali themeltar si dhe vendimet qe merr asambleja e ortakeve.

#### Neni 18

Bilanci finaciar mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.llogarite vjetore , raportet mbi operacionet e vitit finaciar dhe raportet e hartuara nga eksperte kontabel miratohen nga ortaku i vetem.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarin vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit finaciar.

#### Neni 19

Asambleja e ortakeve nepermjet vendimeve qe merr realizon te gjithë veprimtarine e shoqerise.Ajo percakton drejtimet kryesore , vendos per bilancin vjetor , per ndryshimet ne statut , na aktin e themelimit , per shtimin ose pakesimin e kapitalit , per pranimin ne shoqeri te ortakeve te tjere , te gjitha keto ne zbatim te ligjit per shoqerite tregtare.

#### Neni 20

Administratori lidh kontrata me personat fizik e juridik shteteror ose privat, vendas e te huaj si dhe vendos per drejtimin e aktivitetit te shoqerise. Ai vendos per fuqine punetore per pagat e tyre duke lidhur kontrata me ta sipas marreveshjeve te dyaneshme , ne perputhje me ligjet shqiptare.

#### Neni 21

Administratori i shoqerise ka te drejte te emeroj ekonomist dhe avokat si dhe t'ju jap te drejte personave te trete qe te veprojne ne emer e per llogari te tij me autorizim apo me prokure, ne pershtatje e ne perputhje te plote me ligjin shqiptar.

Neni 22

Shperndarja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak , si humbje e kapitalit te shoqerise , pamundesi veprimi ose me vendim te ortakut te vetem . Per kete administratori vendos per menyren e likujdimit te saj. Caktohet nje ose disa likujdatore. Keta bejen kujdes qe shoqeria te likujdoj me pare detyrimet qe ajo u ka personeve fizik e juridik.

Neni 23

Shoqeria "FLORIDA FH" SH.P.K. , ka vulen e saj te bere konform rregullave, ku jane pasqyruar te gjitha inicialet e saj.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 24

Persa nuk eshte shkruar ne kete statut i referohet plotesimeve nga vendimet e Asamblese se ortakeve si dhe ligjeve perkatese shqiptare per shoqerine tregtare.

Neni 25

Te gjitha mosmarreshjet qe mund te linden gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit do t'i paraqiten per zgjidhje gjykates kopetente.

Neni 26

Ky statut eshte hartuar ne 4(kater) kopje per t'u administruar sipas ligjit .

**ORTAKU I VETEM**

**FERAT HASAJ**

